

Gjykata  
Evropiane  
e të Drejtave  
të Njeriut

# GJEDNJ NË 50 PYETJE



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS  
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

GJEDNJ  
në 50 pyetje

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

### 1 Kur është miratuar Konventa?

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e njohur si “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, u çel për nënshkrim në Romë më 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi më 3 shtator 1953.

Konventa konkretizoi disa të drejta të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe themeloi një organ gjyqësor ndërkombëtar kompetent për të marrë vendime kundër Shteteve që nuk i përmbushin detyrimet e tyre.

### 2 Çfarë është një protokoll i Konventës?

Një protokoll i Konventës është një tekst që i shton një ose më shumë të drejta Konventës fillestare, ose ndryshon disa dispozita të caktuara të saj.

Protokollet që i shtojnë të drejta Konventës janë të detyrueshme vetëm për ato Shtete që i kanë nënshkruar dhe ratifikuar ato. Një shtet, që vetëm e ka nënshkruar protokollin, por nuk e ka ratifikuar, nuk është i detyruar të zbatojë dispozitat e protokollit.

Deri më sot janë miratuar 14 protokolle shtesë.

### 3 Çfarë të drejtash mbron Konventa?

Shtetet që kanë ratifikuar Konventën, të njohura edhe si “Shtetet Palë”, kanë marrë përsipër t’i sigurojnë dhe garantojnë çdo individ brenda juridiksionit të tyre, jo vetëm

shtetasve të tyre, të drejtat themelore civile dhe politike të përcaktuara në Konventë.

Të drejtat dhe liritë e siguruar nga Konventa përfshijnë të drejtën për jetën, të drejtën për një proces gjyqësor të rregullt, të drejtën për jetë private dhe familjare, lirinë e shprehjes, lirinë e mendimit, ndërgjegjies dhe fesë, dhe lirinë e mbrojtjes së pronës. Konventa ndalon në veçanti torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruar, punën e detyruar, ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm si dhe diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të siguruar nga Konventa.

### 4 A evoluon Konventa?

Po. Konventa evoluon veçanërisht nëpërmjet interpretimit që i bën dispozitave të saj Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata e ka kthyer Konventën në një instrument të gjallë. Në këtë mënyrë ajo i ka zgjeruar të drejtat e ofruara dhe i ka zbatuar ato për situata që nuk ishin të parashikueshme në kohën kur u miratua Konventa.

Po ashtu, Konventa evoluon nëpërmjet protokolleve të saj të cilat i kanë shtuar të drejta të reja. Për shembull, kjo ka ndodhur në korrik 2003, me Protokollin nr. 13 për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, ose në prill 2005, me Protokollin nr. 12 për mos-diskriminimin.

### 5 A janë gjykatat vendase të detyruara të zbatojnë Konventën?

Konventa është e zbatueshme në nivel kombëtar. Ajo është përfshirë në legjislacionin e Shteteve Palë, të cilat kanë marrë përsipër të mbrojnë të drejtat e përcaktuara në Konventë. Për rrjedhojë, gjykatat vendase duhet ta zbatojnë Konventën. Përndryshe, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Ky dokument, i cili është përgatitur nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nuk është i detyrueshëm për Gjykatën. Në të synohet të jepet informacion i përgjithshëm për mënyrën se si funksionon Gjykata. Për informacion më të hollësishëm, ju mund të lexoni dokumentet e lëshuara nga Sekretariati i Gjykatës. Këto dokumente gjenden në faqen zyrtare të Gjykatës në adresën [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int).

© European Court of Human Rights, 2021

European Court of Human Rights  
Council of Europe  
67075 Strasbourg cedex  
France

do të konstatojë shkelje të Konventës nga ana e Shteteve Palë në rast se individët do të ankohen për mosrespektimin e të drejtave të tyre.

## Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

### 6 Cila është përbërja e Gjykatës?

Numri i gjyqtarëve në Gjykatë është i njëjtë me atë të Shteteve Palë të Konventës.

### 7 Si zgjidhen gjyqtarët e Gjykatës?

Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në bazë të listës prej tre kandidatësh që propozohet nga secili Shtet. Ata zgjidhen për një mandat të parinovueshëm prej nëntë vitesh.

### 8 A janë gjyqtarët vërtet të pavarur?

Megjithëse gjyqtarët zgjidhen për çdo Palë kontraktuese, ata i gjykojnë çështjet si individë dhe nuk përfaqësojnë Shtetin përkatës. Ata janë krejtësisht të pavarur dhe nuk mund të angazhohen në ndonjë aktivitet që do të ishte i papajtueshëm me detyrën e tyre për të qenë të pavarur dhe të paanshëm.

### 9 A marrin pjesë gjyqtarët në çështje që kanë të bëjnë me vendin e tyre?

Gjyqtari i një Pale kontraktuese nuk mund të jetë pjesë e trupit gjykues të përbërë nga një

gjyqtar. Në raste përjashtimore, ai mund të ftohet të bëjë pjesë si anëtarë i një Komiteti. Gjyqtari i Palës kontraktuese përfshihet gjithmonë kur Gjykata shqyrton çështje në Dhomën e përbërë nga shtatë gjyqtarë, ose në Dhomën e Madhe të përbërë nga shtatëmbëdhjetë gjyqtarë.

### 10 Çfarë është Sekretariati i Gjykatës?

Sekretariati i Gjykatës përbëhet nga personeli i cili i jep Gjykatës mbështetje ligjore dhe administrative në punën e saj gjyqësore. Sekretariati i Gjykatës përbëhet nga juristë, nga personeli administrativ dhe teknik si dhe nga përkthyes.

### 11 Çfarë kuptohet me buxhet të Gjykatës?

Shpenzimet e Gjykatës përballohen nga Këshilli i Evropës, buxheti i të cilit financohet nga kontributet e shteteve anëtare, në varësi të popullsisë dhe të PBB-së (produktit të brendshëm bruto).

Buxheti i Gjykatës mbulon rrogat e gjyqtarëve dhe të personelit si edhe shpenzimet e ndryshme operative (për teknologjinë e informacionit, udhëtimet zyrtare, përkthimet me shkrim, përkthimet me gojë, botimet, ndihmën ligjore, shpenzimet për përfaqësimin ligjor si dhe misionet për mbledhje faktesh, etj.).

### 12 A mund të ndryshojë përbërja e Gjykatës nga njëra çështje në tjetrën?

Po, çështjet shqyrtohen nga një prej katër trupave gjykuese kryesore të Gjykatës.

Kërkesat, të cilat janë haptazi të papranueshme, shqyrtohen nga trupi

gjykues i përbërë nga një gjyqtar. Komiteti i përbërë nga tre gjyqtarë mund vendosë me votim të njëzëshëm rreth pranueshmërisë dhe themelit të çështjeve që janë objekt i një praktike të unifikuar të Gjykatës. Kërkesa mund t'i kalohet për shqyrtim një Dhome të përbërë nga shtatë gjyqtarë, e cila vendos me shumicë vote, kryesisht rreth pranueshmërisë dhe themelit të një çështjeje.

Në raste përjashtimore, Dhome e Madhe me 17 gjyqtarë shqyrton çështjet që i janë përcjellë ose kur Dhome heq dorë nga juridiksioni i saj, ose kur është pranuar një kërkesë për kalimin e çështjes në Dhomë të Madhe.

### 13 Cili është dallimi ndërmjet Dhomës dhe Seksionit?

Seksioni është organ administrativ, kurse Dhome është një trup gjyqësor që bën pjesë në një nga Seksionet e Gjykatës.

Gjykata ka pesë Seksione në të cilat bëjnë pjesë Dhomat. Çdo Seksion ka një kryetar, një nën-kryetar dhe një numër gjyqtarësh.

### 14 Si formohen Dhomat dhe Dhome e Madhe?

Dhome përbëhet nga Kryetari i Seksionit të cilit i është caktuar çështja, gjyqtari i Palës kontraktuese (gjyqtari i zgjedhur në emër të Shtetit kundër të cilit është bërë kërkesa) dhe pesë gjyqtarë të tjerë të emëruar me rotacion nga Kryetari i Seksionit.

Dhome e Madhe përbëhet nga kryetari dhe nën-kryetarët e Gjykatës, kryetarët e seksioneve dhe gjyqtari i Palës kontraktuese (gjyqtari i zgjedhur në emër të Shtetit kundër të cilit është bërë kërkesa), si dhe nga gjyqtarët e tjerë, që zgjidhen me short. Kur shqyrton një çështje që i është kaluar asaj

pas vendimit të nxjerrë nga Dhome, Dhome e Madhe nuk përfshin gjyqtarët të cilët kanë qenë anëtarë të trupit gjykues të Dhomës që e ka shqyrtuar çështjen fillimisht.

### 15 Kur shqyrtohet një çështje nga Dhome e Madhe?

Një çështje mund të kalojë në Dhomën e Madhe në dy forma: në rast se kërkohet referimi i çështjes në Dhomë të Madhe ose kur ka heqje dorë nga juridiksioni nga ana e Dhomës.

Pasi është shpallur vendimi i Dhomës, palët mund të kërkojnë kalimin e çështjes në Dhomën e Madhe. Kërkesa pranohet në raste përjashtimore. Kolegji i Dhomës së Madhe vendos nëse çështja duhet t'i përcillet Dhomës së Madhe për shqyrtim të ri apo jo.

Çështjet i dërgohen Dhomës së Madhe edhe kur Dhome heq dorë nga juridiksioni, megjithëse edhe kjo ndodh në raste përjashtimore. Dhome së cilës i caktohet një çështje mund ta dërgojë çështjen në favor të juridiksionit të Dhomës së Madhe, nëse çështja ngre një problem të rëndësishëm që çënon interpretimin e Konventës ose, nëse ekziston rreziku i papërputhshmërisë me një vendim të mëparshëm të Gjykatës.

### 16 A mundet një gjyqtar të mos pranojë të marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje?

Po. Madje gjyqtarët janë të detyruar të mos marrin pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, kur janë përfshirë më parë në atë çështje në çfarëdolloj mënyre. Kjo quhet tërheqje. Ata zëvendësohen në procedurë nga një gjyqtar tjetër dhe, nëse ai që tërhiqet është gjyqtari i zgjedhur në emër të Palës Kontraktuese, atëherë ai mund të zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër apo nga një gjyqtar *ad hoc*.

## 17 Çfarë është gjyqtari ad hoc?

Gjyqtari *ad hoc* emërohet nga Qeveria përkatëse kur gjyqtari i zgjedhur në emër të asaj Pale Kontraktuese nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjes për shkak të pamundësisë, tërheqjes ose përjashtimit.

## 18 Cila është kompetenca e Gjykatës?

Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje me iniciativën e saj. Ajo ka kompetencë të shqyrtojë pretendimet për shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe këtë e bën përmes pranimit të kërkesave individuale ose ndër-shtetërore.

## Procedura para Gjykatës

## 19 Kush mund të paraqesë një çështje në Gjykatë?

Konventa dallon dy lloj kërkesash: kërkesat individuale, të depozituara nga një person, grup individësh, kompani ose OJQ, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, si edhe kërkesat ndër-shtetërore, të depozituara nga një shtet kundër një shteti tjetër.

Që nga koha e themelimit të Gjykatës, pothuajse të gjitha kërkesat janë depozituar nga individë të cilët i kanë sjellë çështjet e tyre drejtpërdrejt në Gjykatë me pretendimin se u janë bërë një apo më shumë shkelje të Konventës.

## 20 Kundër kujt mund të drejtohet një çështje?

Çështjet mund të ngrihen kundër një ose më shumë shteteve që kanë ratifikuar Konventën. Çdo kërkesë drejtuar kundër shteteve të treta ose, për shembull, kundër individëve të tjerë, shpallet e papranueshme.

## 21 Si mund të paraqitet një çështje para Gjykatës?

Çështjet mund të paraqiten në Gjykatë nga vetë individët. Ndiheja e një avokati nuk është e nevojshme në fillim të procedurës. Mjafton t'i dërgohet Gjykatës formulari i plotësuar si duhet, bashkë me dokumentet e kërkuara. Megjithatë, regjistrimi i një kërkesë nga Gjykata nuk do të thotë se çështja do të deklarohet e pranueshme apo do të jetë e suksesshme në themel.

Konventa parashikon një sistem "të lehtë" për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë, duke mundësuar çdo person të sjellë çështjen në Gjykatë, pavarësisht nëse jeton në një zonë të largët të një shteti anëtar apo nëse nuk ka të holla. Pikërisht, për këtë arsye, procedura para Gjykatës është falas.

## 22 Cili është dallimi ndërmjet një kërkesë individuale dhe një kërkesë ndër-shtetërore?

Shumica e kërkesave të paraqitura në Gjykatë janë individuale të cilat dërgohen nga persona privatë. Edhe një Shtet mund të paraqesë një kërkesë kundër një Shteti tjetër Palë të Konventës; kjo kërkesë quhet ndër-shtetërore.

## 23 A është i nevojshëm përfaqësimi nga një avokat në procedurat para Gjykatës?

Përfaqësimi ligjor nuk është i domosdoshëm në fillim të procedurës; çdo individ mund ta dërgojë çështjen e tij drejtpërdrejt në Gjykatë. Ndiheja e avokatit bëhet e domosdoshme në momentin kur Gjykata fton qeverinë e paditur të paraqesë vëzhgimet e saj. Ndiheja ligjore mund t'u jepet ankuesve, nëse është e nevojshme, vetëm në këtë fazë të procedurës.

## 24 Kush ka të drejtë të dorëzojë parashtrimet në Gjykatë?

Gjykata nuk ka ndonjë listë avokatësh të autorizuar për të përfaqësuar ankuesit në procedurën para Gjykatës. Ankuesi mund të përfaqësohet nga një jurist, i cili është i kualifikuar për të ushtruar profesionin në njërin nga Shtetet Palë të Konventës ose që është autorizuar nga Kryetari i Dhomës ta përfaqësojë në procedurën para Gjykatës.

## 25 Cilat janë etapat e procedurës para Gjykatës?

Në shqyrtimin e çështjeve të sjella para Gjykatës ka dy faza kryesore: faza e pranueshmërisë dhe faza e shqyrtimit të themelit (d.m.th. shqyrtimi i ankesave që janë ngritur nga ankuesi). Kërkesa kalon nëpër disa etapa.

Trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar e shpall kërkesën të papranueshme kur papranueshmëria duket qartë që në fillim. Vendimet e këtij gjyqtari nuk mund të ankimohen.

Komiteti merr vendim për një çështje që mbulohet nga një praktikë e unifikuar e Gjykatës.

Dhoma i komunikon çështjen qeverisë së paditur dhe e fton të paraqesë vëzhgimet e saj. Vëzhgimet këmbëhen midis palëve. Pastaj Gjykata vendos nëse është e nevojshme të zhvillojë një seancë publike lidhur me çështjen. Seancat publike, duke parë numrin e kërkesave të shqyrtuara nga Gjykata, bëhen vetëm në raste përjashtimore. Në fund, Dhoma shpall vendimin, i cili bëhet përfundimtar vetëm pas kalimit të periudhës tre-mujore gjatë së cilës kërkuesi ose qeveria mund të kërkojnë kalimin e çështjes në Dhomën e Madhe për një shqyrtim të ri. Nëse kërkesa për kalimin e çështjes pranohet nga kolegji i Dhomës së Madhe, çështja rishqyrtohet dhe, nëse është e nevojshme, zhvillohet një seancë publike. Vendimi i Dhomës së Madhe është i formës së prerë.

## 26 Cilat janë kushtet e pranueshmërisë?

Që të shpallet e pranueshme nga Gjykata, kërkesa duhet të plotësojë disa kushte. Përndryshe, kërkesa nuk do të merret në shqyrtim. Çështjet mund të sillen në Gjykatë

vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore. Kjo do të thotë se individët të cilët ankohen për shkelje të të drejtave të tyre në fillim duhet ta kenë kaluar çështjen nëpër të gjitha gjykatat vendase, deri në jurisdikcionin më të lartë. Në këtë mënyrë, Shtetit i jepet mundësia të korrigjojë, në nivel kombëtar, shkeljet e pretenduara.

Pretendimet e kërkuarit duhet të kenë të bëjnë me një ose më shumë se një nga të drejtat e përcaktuara në Konventë. Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa që kanë të bëjnë me shkelje të ndonjë të drejte tjetër që nuk është e përcaktuar në Konventë. Po kështu, kërkesa duhet të paraqitet në Gjykatë brenda katër muaj pas vendimit të fundit gjyqësor që është marrë lidhur me çështjen, që zakonisht është vendimi i gjykatës më të lartë të vendit në fjalë. Ankuesi duhet që, personalisht, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, të jetë viktimë e një shkeljeje të Konventës dhe, duhet të ketë pësuar një dëm të konsiderueshëm. Sigurisht që nuk duhet harruar që kërkesat mund të paraqiten vetëm kundër një ose më shumë se një prej Shteteve Palë të Konventës, dhe jo kundër ndonjë Shteti tjetër që nuk e ka ratifikuar Konventën apo kundër ndonjë individi.

## 27 A lejohen OJQ-të ose shtetet të marrin pjesë në procedurë?

Po, si OJQ-të, ashtu dhe Shtetet mund të paraqesin kërkesa. Madje, ato mund të autorizohen edhe nga Kryetari i Gjykatës që të ndërhyjnë në procedurë si palë e tretë.

## 28 Çfarë është pala e tretë e interesuar?

Përveç kërkuarit, Kryetari i Gjykatës mund të autorizojë një person ose një shtet tjetër që është Palë e Konventës, përveç shtetit

kundër të cilit është paraqitur kërkesa, të ndërhyjë në procedurë. Kjo quhet ndërhyrje nga një palë e tretë. Personi ose shteti në fjalë ka të drejtë të paraqesë vëzhgime dhe të marrë pjesë në seanca publike.

## 29 A mund të caktojë Gjykata ekspertë ose të marrë prova nga dëshmitarë?

Po. Në raste përjashtimore, një delegacion nga Gjykata mund të vendosë të kryej misione hetimore duke u zhvendosur në shtete të tjera për të qartësuar faktet e një çështjeje. Ky delegacion mund të marrë prova nga individë dhe të kryejë hetime në vendngjarje.

Në disa raste Gjykata cakton ekspertë, për shembull, kur kërkon që mjekë ekspertë të ekzaminojnë kërkuarit të cilët ndodhen në burg.

## 30 A zhvillon Gjykata seanca publike?

Procedura para Gjykatës është me shkrim, por në disa raste dhe për çështje të caktuara Gjykata vendos të zhvillojë seancë publike.

Seancat zhvillohen në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Ato zakonisht janë publike, me përjashtim të rasteve kur Kryetari i Dhomës ose Dhoma e Madhe, në varësi të çështjes, vendosin ndryshe. Shtypi dhe publiku zakonisht lejohen të marrin pjesë. Për këtë, ata duhet të jenë të pajisur me dokumentin identifikues të medias që përfaqësojnë ose me letërnjoftim.

Të gjitha seancat filmohen dhe transmetohen brenda ditës në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës, duke filluar pas orës 14.30 (ora vendore).

## 31 Çfarë kuptohet me kundërshtime fillestare?

Kundërshtime fillestare janë argumentet që paraqet qeveria e paditur në mbështetje të pretendimeve të saj se çështja nuk duhet të shqyrtohet në themel.

## 32 Çfarë kuptohet me zgjidhje miqësore?

Zgjidhja miqësore është marrëveshja ndërmjet palëve që ka për qëllim t'i japë fund çështjes. Kur palët e përfshira bien dakord që ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre në këtë mënyrë, Shteti i paguan kërkuarit një shumë parash. Pas shqyrtimit të kushteve të zgjidhjes miqësore, dhe vetëm në rast se Gjykata arrin në përfundimin se është siguruar respektimi i të drejtave të njeriut, atëherë ajo e fshin kërkesën nga lista e çështjeve të saj.

Gjykata i nxit gjithnjë palët të zhvillojnë bisedime për gjetjen e zgjidhjes miqësore. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje, Gjykata vazhdon me shqyrtimin e themelit të çështjes.

## 33 A mundet Gjykata të urdhërojë marrjen e masave të përkohshme?

Pas marrjes së një kërkesë, Gjykata mund t'i kërkojë Shtetit të paditur që të marrë disa masa të përkohshme, ndërkohë që vetë Gjykata vazhdon shqyrtimin e çështjes. Kjo do të thotë që Shtetit përkatës i kërkohet që të mos ndërmarrë asnjë veprim, si, për shembull, të mos kthejë individë të caktuar në vendin nga i cili kanë ardhur ku ata pretendojnë se mund të gjejnë vdekjen ose t'i nështrohen torturës.

## 34 A janë të hapura për publikun seancat e vendimmarrjes?

Jo, seancat e vendimmarrjes janë zhvillohen me dyer të mbyllura.

## 35 A kanë refuzuar ndonjëherë Shtetet të bashkëpunojnë me Gjykatën?

Ka pasur raste kur shtete të caktuara kanë munguar, madje kanë refuzuar t'i japin Gjykatës informacione dhe dokumente të nevojshme për shqyrtimin e kërkesës nga ana e Gjykatës.

Në këto raste Gjykata mund të dënojë Shtetin përkatës në bazë të Nenit 38 të Konventës (që i detyron Shtetet t'i krijojnë Gjykatës të gjitha lehtësitat e nevojshme).

## 36 Sa kohë zgjat procedura para Gjykatës?

Është e vështirë të thuhet se sa zgjat procedura para Gjykatës.

Gjykata përpiqet t'i trajtojë çështjet brenda tre viteve që nga data e dorëzimit të tyre. Megjithatë, shqyrtimi i disa çështjeve mund të marrë më shumë kohë, ndërkohë që disa të tjera mund të shqyrtohen më shpejt.

Kohëzgjatja e procedurës ndryshon sigurisht në varësi të çështjes, të trupit gjykues të cilit i është caktuar, kujdesit të palëve për t'i dhënë Gjykatës informacionin e duhur dhe shumë faktorëve të tjerë, si zhvillimi i një seance publike ose kalimit të çështjes në Dhomën e Madhe.

Disa kërkesa mund të konsiderohen urgjente dhe të trajtohen me përparësi, sidomos në rastet kur integriteti fizik i kërkuarit vihet në rrezik dhe kërcënohet në mënyrë të menjëhershme.

## Vendimet e Gjykatës

### 37 Cili është dallimi ndërmjet vendimeve që merren nga Gjykata?

Zakonisht një vendim jepet nga trupi gjykses i përbërë nga një gjyqtar, nga Komiteti ose nga Dhoma e Gjykatës. Ai ka të bëjë vetëm me pranueshmërinë dhe jo me themelin e çështjes. Normalisht, është Dhoma ajo që shqyrton pranueshmërinë dhe themelin e një çështje në të njëjtën kohë e pastaj shpall vendimin e saj.

### 38 A janë vendimet e Gjykatës të detyrueshme për Shtetet ?

Vendimet që kanë identifikuar shkelje të Konventës janë të detyrueshme për Shtetet përkatëse, të cilat duhet t'i ekzekutojnë ato. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës monitoron ekzekutimin e vendimeve, veçanërisht përsa i përket pagimit nga ana e Shteteve të shumave të caktuara nga Gjykata si kompensim për dëmin që u është shkaktuar ankuesve.

### 39 A mund të apelohej një vendim i Gjykatës?

Vendimet e papranueshmërisë, si dhe vendimet e marra nga një Komitet ose nga Dhoma e Madhe, janë të formës së prerë dhe nuk mund të apelohej. Megjithatë, brenda tre muajve pas njoftimit të vendimit të Dhomës, palët kanë të drejtë të kërkojnë kalimin e çështjes në Dhomë të Madhe për rishqyrtim. Kërkesat për kalim të çështjes në Dhomë të Madhe shqyrtohen nga një trupë gjyqtarësh të cilët vendosin nëse kalimi është me vend apo jo.

### 40 Si ekzekutohen vendimet e Gjykatës?

Kur Gjykata shpall një vendim për një shkelje që është bërë, ajo ia përcjell dosjen Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili përcakton me Shtetin e paditur dhe departamentin e ekzekutimit të vendimeve modalitetet për ekzekutimin e vendimit dhe për parandalimin e shkeljeve të ngjashme të Konventës në të ardhmen. Kjo shoqërohet me marrjen e masave me karakter të përgjithshëm, sidomos me ndryshimin e legjislacionit, dhe me marrjen e masave individuale kur është e nevojshme.

### 41 Cilat janë pasojat e një vendimi që konstaton shkelje?

Në rast se konstatohet se ka pasur shkelje, Shteti i paditur duhet të bëjë kujdes që këto shkelje të mos ndodhin sërish në të ardhmen, përndryshe Gjykata mund ta dënoj sërish atë. Në disa raste, Shteti do t'i duhet të ndryshojë legjislacionin për ta përshtatur me Konventën.

### 42 Çfarë është shpërblimi i drejtë?

Kur Gjykata vendos kundër një Shteti dhe vëren se kërkuesi ka pësuar dëm, ajo i jep kërkuesit kompensim të drejtë, domethënë i jep një shumë parash si kompensim për dëmin që ka pësuar. Komiteti i Ministrave merr masat që shuma e caktuar nga Gjykata t'i paguhet konkretisht kërkuesit.

### 43 Çfarë është një çështje pilot?

Gjatë viteve të fundit, Gjykata ka ndjekur një procedurë të re për të përballuar fluksin masiv të kërkesave që kanë të bëjnë me problematikë të ngjashme. Këto kërkesa njihen gjithashtu si “çështje sistemike” –

d.m.th. që e kanë origjinën në mospërputhjen e së drejtës së brendshme me Konventën.

Kështu, kohët e fundit Gjykata ka ndjekur një procedurë që konsiston në shqyrtimin e një ose më shumë kërkesave të këtij lloji dhe ka shtyrë shqyrtimin e një sërë çështjesh të ngjashme me to . Sapo shpall vendimin e saj për një çështje pilot, Gjykata i kërkon qeverisë përkatëse të ndryshojë legjislacionin e brendshëm në mënyrë që ai të jetë në harmoni me Konventën, si dhe i tregon në mënyrë të përgjithshme masat që duhen ndërmarrë. Vetëm më pas Gjykata shqyrton serinë e çështjeve të tjera të ngjashme me çështjen pilot.

### 44 Çfarë është mendimi paraleli pakicës?

Gjyqtarët mund të dëshirojnë të përpilojnë mendimin e tyre lidhur me një çështje që është shqyrtuar nga trupi gjykses ku ato bëjnë pjesë. Ky mendim i bashkëngjitet vendimit . Në përgjithësi ata shpjegojnë përse votuan me shumicën (mendimi paralel) ose, e kundërta, përse nuk ranë dakord me shumicën e gjyqtarëve (mendimi i pakicës).

## Aktiviteti i Gjykatës

### 45 Sa çështje janë paraqitur në Gjykatë?

Gjykata ka qenë viktimë e suksesit të saj. Çdo vit janë paraqitur mbi 50,000 kërkesa të reja. Disa nga vendimet e Gjykatës, si edhe fakti që shumë shtete e vlerësojnë gjithnjë e më shumë punën e Gjykatës, kanë bërë që numri i rasteve të rritet në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit.

### 46 Cilat të drejta ngrihen në shumicën e çështjeve?

Që nga themelimi i saj, në rreth gjysmën e vendimeve, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 6 të Konventës, lidhur me paanshmërinë dhe kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Në fakt, 58% e shkeljeve të gjetura nga Gjykata kanë të bëjnë ose me Nenin 6 (e drejta për një proces të rregullt) ose me Nenin 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës). Pastaj, në rreth 11% të çështjeve, Gjykata ka gjetur shkelje të rëndë të neneve 2 dhe 3 të Konventës (e drejta për jetën dhe ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues).

### 47 A janë masat e përkohshme vërtet të efektshme?

Shtetet ndjekin pothuajse gjithmonë rekomandimet e Gjykatës lidhur me masat e përkohshme. Ka raste që disa prej tyre të mos kenë vepruar sipas kërkesave të Gjykatës. Këto shtete rrezikojnë të dënohen nga Gjykata për moszbatim të detyrimeve të tyre të parashikuara në Nenin 34 (e drejta për kërkesë individuale).

### 48 A merret Gjykata me ndonjë çështje që ka të bëjë me shoqërinë?

Sigurisht, Gjykatës i është kërkuar të trajtojë çështje që nuk ishin të parashikueshme në vitin 1950 kur Konventa u nënshkrua. Gjatë 50 viteve të fundit Gjykata ka vendosur për shumë çështje që kanë të bëjnë me shoqërinë, si çështja e abortit, vetëvrasja e asistuar, kontrolli trupor, skllavëria familjare, e drejta e një personi të lindur në mënyrë anonime për të njohur origjinën e tij, e drejta për birësimin nga ana e personave homoseksualë, mbajtja e perçes islamike në

# Pyetje që bëhen më shpesh

shkolla dhe universitete, mbrojtja e burimeve të gazetareve, diskriminimi kundër Romëve dhe problemet e mjedisit.

## **E ardhmja e Gjykatës**

### **49 Çfarë është Protokollin nr. 14?**

Protokollin nr. 14, qëllimi i të cilit është të garantojë efektivitetin afatgjatë të Gjykatës duke optimizuar filtrimin dhe përpunimin e kërkesave, parashikon në veçanti krijimin e trupave të reja gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve më të thjeshta, si dhe parashikon edhe një kriter të ri pranueshmërie (ekzistenca e një “dëmi të konsiderueshëm”), dhe zgjat mandatin e gjyqtarëve deri në nëntë vjet, pa mundësinë për tu rizgjedhur. Ky Protokoll hyri në fuqi më 1 qershor 2010.

### **50 Cilat janë projektet për realizimin e reformës?**

Pavarësisht nga Protokollin nr. 14, u pa e nevojshme që të reformohej më tej sistemi i Konventës. Në nëntor 2006, Grupi i të Urtëve, i përbërë nga juristë të shquar, paraqiti një raport para Komitetit të Ministrave. Grupi rekomandoi, ndër të tjera, krijimin e një mekanizmi të ri gjyqësor filtrues dhe përpunimin e një Statuti lidhur me disa aspekte strukturore të funksionimit të Gjykatës. Ky statut kishte për qëllim që modalitetet për të bërë ndryshime të ishin më elastike sesa procedura që ndiqej për traktatet ndërkombëtare dhe që duhej të zbatohesh edhe për Konventën. Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës po i shqyrton aktualisht të gjitha këto propozime.





[www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int)